



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 11, dt. 08.01.2016

Në mbështetje të nenit 28 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Banesa e Lluka Gjidedës”, në fshatin Ilias, Himarë.
 2. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Muret rrethuese të Aulonës”, Sheshi i Flamurit, Vlorë.
 3. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Ura e Gjipesë” Ilias, Himarë.
 4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI